



Më
Dana 18-02-2019

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:058407

Datë: 11.01.2019

Numri i dokumentit: 00203218

P.nr.214/14

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin Ilir Bytyqi si dhe procesmbajtësen Mimoza Shabani, bashkëpunëtore profesionale, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED] K. Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2381-5/13 dt.25.02.2014, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor dhe publik të mbajtur me datë 10.12.2018, në praninë e Prokurorit të Shtetit Albert Zejnullahu, përfaqësuesit juridik të DBP-së [REDACTED] si dhe të pandehurit [REDACTED] me datë 10.12.2018 mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 19.12.2018 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: [REDACTED] i lindur më [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], i martuar prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me vendbanim në Fshatin [REDACTED] K. Ferizaj, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal [REDACTED].

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 13.11.2013, rreth orës 13:48, në pyllin publik, në vendin e quajtur “Ngastra 33-Jezerc” në Rajonin Ekonomiko Pyjore në Neredime – Jezercë, me qëllim vjedhje ka prerë me sharre motorike 2 copë trungje të ahut të njomë, me diametër 64-38 cm, me gjatësi prej 26 metra, me vëllim të përgjithshëm prej 5.47 metra kub dhe se bartjen e ka bërë me traktor IMT-540, duke i shkaktuar Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari, dëm material në vlerë prej 738.45 Euro.

me këtë ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,4,7,8,17,41,42,49,50,51,52,73, nenit 358 par. 2 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 453,463, të KPPRK-së, të pandehurin [REDAKTUAR], e

G J Y K O N

- Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 /gjashtë/ Muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 Euro /treqind/, të cilat dënime nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 /një/ Viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në qoftë se i pandehuri gjatë kësaj kohe nuk do të kryej vepër penale.
- Obligohet i akuzuari, në emër të kërkesës pasurore-juridike, të dëmtuarës DBP-Ferizaj, t’ia paguaj dëmin në shumën prej 738.45 Euro.
- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, në afatin prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Obligohen të akuzuarit që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajnë në mënyrë solidare shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokurori Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2381-5/13 dt.25.02.2014 ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Ferizaj, për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 KPRK-së, duke propozuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 10.12.2018, në të cilën shqyrtim gjyqësor: *i akuzuari [REDAKTUAR] deklaroi se pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saj, është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, ndihet thellë i penduar për veprimet e mia në drejtim të kryerjes së veprës penale, njoftoj gjykatën se është hera e parë që ndeshet me ligjin, mbajtës i familjes dhe i gjendjes së dobët ekonomike, duke kërkuar nga Gjykata që ti shqiptoj një dënim më të butë duke u bazuar në ligj.*

Prokurori i Shtetit Albert Zejnullahu duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit, pranimi është i bazuar në gjendjen faktike të përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze dhe provat materiale që gjenden në lende, i njëjti pranim është bërë në mënyrë vullnetare në përputhje të plote me dispozitat e nenit 248, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënimin e merituar.

Meqë i pandehuri ka pranuar fajësinë gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së: i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjenden në shkresën e lendes siç janë: fletëparaqitja e rojës së pyllit me nr. ditari 210-13 e dt.19.11.2013, procesverbali mbi vlerësimin e demit NP-690-2013 e dt.14.11.2013, raporti i rojës së pyllit [REDAKTUAR] i dt.19.11.2013 si dhe fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi këtë gjendje të fakteve si në vijim: se me datë 13.11.2013, rreth orës 13:48, në pyllin publik, në vendin e quajtur “Ngastra 33-Jezerc” në Rajonin Ekonomiko Pyjore në Nerodime – Jezercë, është takuar duke prere me sharre motorike 2 copë trungje të ahut të njomë, me diametër 64-38 cm, me gjatësi prej 26 metra, e vëllim të përgjithshëm prej 5.47 metra kub dhe se bartjen e ka bërë me traktor IMT-540, duke i shkaktuar DBP-së, dëm material në vlerë prej 738.45 Euro.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së, si në kohën, datën dhe vendin e përcaktuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, nuk është vërtetuar se ka qenë i dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, e që këto rrethana i ndërlidhi me rrethanat personale, i gjendjes së dobët ekonomike, mbajtës i familjes, nuk ka ndonjë aktgjykim të formës së prerë ndaj tij e në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale,

rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.


Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.214/14 e dt.19.12.2018

B. Profesionale

Mimoza Shabani

Gjyqtari: Ilir BYTYQI



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.